
THE PROCES OF LEXICAL EXPANSION IN SEVERAL FIELDS DEFINED BY LIFE ACTIVITIES OF ALBANIANS

PROCESI I ZGJERIMIT LEKSIKOR NË DISA FUSHA TË PËRCAKTUARA SIPAS VEPRIMTARIVE JETËSORE TË SHQIPTARËVE

AIDA BADO
Universiteti i Tiranës,
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë, SHQIPËRI
Email: aida14071985@yahoo.it

AKTET VI, 4: 352-355, 2013

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i punimit lidhet me dëshirën për të parë sa është ndierë dinamizmi gjuhësor në fusha të tilla si: fusha e politikës, e drejtësisë dhe e mjekësisë gjatë viteve 1980-2006. Gjithashtu është përcaktuar se burimi nga do të merret korpusi leksikor që qëndron në bazë të këtij punimi është *Fjalori i gjuhës shqipe* (2006) dhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980), botime të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me metodën e krahasimit, nga këta dy fjalorë janë nxjerrë dy korpusë leksikore:

(a) korpusi i fjalëve që ndodhen vetëm në fjalorin e vitit 1980; dhe

(b) korpusi i fjalëve që ndodhen vetëm në fjalorin e vitit 2006.

Këto korpusë janë grupuar në njësi më të vogla, të quajtura nga ne fusha, të përcaktuara sipas veprimtarisë jetësore të shqiptarëve. Për secilën nga fushat jemi përpjekur të kuptojmë arsyet që kanë çuar në shtimin e njërive të reja leksikore dhe rrudhjen (mospërdorimin) e disa të tjerave.

Fjalë kyçe: zgjerim, fushë leksikore, shqipe

SUMMARY

The purpose of the paper relates with the desire to observe the impact thereof, in different fields such as politics, justice and medicine during the period 1980-2006. As a reference material for the lexical corpus are going to be two publications from the Albanian Science Academy, "Albanian vocabulary", 2006 and "Albanian vocabulary of today", 1980. By comparison of the two vocabularies, two different lexical corpuses are determined. The first contains all the words present only on the publication of 1980 and the second, the words present only on the later publication. These are then grouped in smaller units, named fields, defined by the life's activities of Albanians. For every of the above mentioned fields we tried to study the reasons which have lead to the increased use of some new lexical units and the contraction (disuse) of others.

Key words: expansion, lexical field, Albanian

HYRJE

Që në fillim mund të themi se gjuha është një "mjet", të cilën shoqëria e krijon dhe "tjetëron" dita-ditës, duke e përshtatur me nevojat komunikative të grupit që e përdor. Natyrisht, zhvillimi i këtyre nevojave është i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin intelektual, sho-

qëror, ekonomik të këtij grupi. Një mënyrë e mirë për të vënë re këtë "tjetërsim" të gjuhës është me anë të fjalorit.

Fjalorin mund ta krahasojmë me një fotografi. Sikur-se fotografia shërben për të fiksuar në kohë imazhe e detaje, ashtu edhe në fjalor "fiksohet" fjalësi që grupi shoqëror e përdorë në

kohë. Nëse do të donim të shi-konim sa kemi ndryshuar në kohë, na mjafton të kra-ha-sojmë fotografitë e bëra, por, nëse do të donim të shi-konim sa gjuha (fjalësi) që ne përdorim ka ndryshuar në kohë, atëherë mund të na ndihmojë kra-ha-si-mi i fjalorëve mes tyre. Pra, me anë të fjalorëve ne mund të bëjmë një fotografim gjuhësor.

Objekti i studimit tonë lidhet pikërisht me dëshirën për të parë sa është ndierë ky ndryshim në fusha të ti-lla si: fusha e politikës, fusha e drejtësisë dhe fusha e mje--kësisë gjatë viteve 1980-2006. Janë marrë në shqy--rtim këto fusha, pasi këto janë disa nga fushat më kryesore që kanë pësuar ndryshime më të mëdha gja--të kalimit nga sistemi diktatorial në atë demo--kratik.

Për ta bërë këtë do t'i referohemi dy fjalorëve të gju-hës shqipe: Fjalorit të gjuhës shqipe (2006) dhe Fja-lo-rit të gjuhës së sotme shqipe (1980), botime të Aka-de-misë së Shkencave të Shqipërisë. Nga këta dy fja-lo-rë është nxjerrë korpusi i fjalëve që bëjnë pjesë ve-tëm në fjalorin e vitit 2006 (fjalorthe 2006) dhe ko-r-pusi i fja--lëve që bëjnë pjesë vetëm në fjalorin e vitit 1980 (fjalorthe 1980).

Natyrsh, të dhënat që do të japim me anë të këtyre fja--lorëve janë relative dhe po plotësohen edhe më tej, për arsye se fjalorët së pari, janë të tipave të ndry-shëm dhe së dyti, ato nuk mund të pasqyrojnë në më-ny-rë të plotë gjithë leksikon që është përdorur ose për--doret sot në ligjërimin e folur a të shkruar.

1.1. Procesi i zgjerimit dhe ngushtimit të fushës së politikës dhe të drejtësisë

Pas vendosjes së pluralizmit në vendin tonë (pas vitit 1990), leksiku i fushës politike dhe i drejtësisë është rri-tur dhe është pasuruar më shumë, por kjo nuk do të tho-të se nuk kanë humbur njësi të tjera. Zhvillimi, pa-su-rimi dhe vjetrimi i këtyre fushave lidhet me bo-të-ku-ptimet e reja të fituara me vendosjen e plu-ra-li-z-mit.

Meqenëse shoqëria shqiptare nuk drejtohet më nga do--gma marksiste-leniniste edhe fjalë të tilla si: leni-nist, - e; leninizëm, marksist-leninist, marksizëm-le-ni-ni--zëm, nacional – çlirimtar,

nacional – socializëm, tro--c-kizëm sot nuk përdoren më në fushën e politikës ose përdoren shumë rrallë. Ndoshta kjo është edhe ar-sy--eja pse këto fjalë nuk gjenden në Fjalorin e gju-hës shqipe (2006).

Po ashtu, meqenëse politika, para vendosjes së plu-ra-li-zmit, u vu në plan të parë, çdo gjë që dilte kundër saj luftohej. Për këtë shërbyen fjalë të tilla si: agji-t-p-rop, anti-amerikan, antiburokratik, antiimpe-ria-list, anti-kapitalist, antikoloniste, antikonolizëm, arqio-marksist.

Sot bindje të tilla politike i përkasin së kaluarës, ndaj në vend të këtyre fjalëve në leksikon e kësaj fushe do të gjejmë fjalë të tilla si: eurodeputet, europar-la-men-tar, europa-ndimor, komisioner, kongresmen, mo-cion, pluralist, ndërkuftar, të cilat nuk shprehin më një qëndresë kundër Evropës, por një dëshirë për t'u bë-rë pjesë e saj.

Po kështu, para viteve '90, pra në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980), nuk gjejmë fjalët: privatizoj, pri-vatizim, i privatizuar edhe pse fjala privat dhe çka ajo nënkuptonte njëhej mjaft mirë. Kjo do të thotë se pa-ra '90-s privatizimi si "njohja me ligj e diçkaje si pro-në private" nuk ekzistonte, pasi drejtimi politik i Shqi-përisë në atë kohë ishte i tillë. Po kështu, nuk për-doreshin fjalë të tilla si: antikontrabandë, ekstra-doj, ekstradim meqenëse në atë kohë Shqipëria ishte një vend i izoluar dhe probleme të tilla nuk ishin kthyer ende në dukuri që duheshin luftuar.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për fushën e dre-j-të-sisë, pasi ajo është e lidhur ngushtë me fushën e politikës.

Për të pasqyruar më mirë se sa janë zgjeruar apo çfa-rë ndryshimesh të tjera kanë pësuar këto fusha, na vi-j--në në ndihmë tabelat e mëposhtme. Për nxjerrjen e të dhë-nave jemi mbështetur vetëm në fjalorthein e vitit 2006 dhe fjalorthein e vitit 1980, d.m.th. do të merren në shqyrtim vetëm leksemat e reja dhe leksemat që nuk paraqiten në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006). Le-k-semat e përbashkëta për të dy fjalorët nuk do të me-rren në shqyrtim, veç në rastet kur paraqiten me ngu-shtime a zgjerime kuptimore. Këtu do të merren pa-rasysh edhe leksemat e

këtyre fushave, por që i ke-mi përfshirë tek fusha e emërtimeve me burim libror.

Tabela për fushën e politikë

Fjalorët:	Nr. i leksemave
Fjalorthi 1980	≈ 50
Fjalorthi 2006	≈ 62

Tabela për fushën e drejtësisë

Fjalorët:	Nr. i leksemave
Fjalorthi 1980	≈ 22
Fjalorthi 2006	≈ 41

Me anë të këtyre shifrave mund të kuptojmë se kemi një rritje të numrit të njësive të pasqyruara në fjalor, për të dyja fushat, por edhe lënien jashtë tyre të disa një-sive të tjera. Njësitë e reja, të pasqyruara në fja-lo-rin e 2006-s janë më së shumti terma me burim nga gju-hët e huaja.

1. 2. Procesi i zgjerimit dhe ngushtimit të fushës së mjekësisë

Fusha -e mjekësisë është njëra ndër fushat që ka pë-suar një zgjerim të madh të leksikut, këta dhjetëv-je-ça-rët e fundit, sepse ajo lidhet me sistemin e termave a fja-lëve që kanë të bëjnë me konceptet “sëmundje”, “pjesë e trupit” dhe “mjekim”, të cilat janë të pa-n-da-sh--me nga jeta e një njeriu. Si tërësi leksikore ajo ësh-të përbërë nga fjalë a terma të huazuara nga gjuhët e tje-ra, të cilat më pas e kanë zgjeruar çerdhen e tyre le-k-si-kore me mjetet e shqipes.

Procesi i zgjerimit të kësaj fushe është kushtëzuar nga di-sa faktorë jashtëgjuhësor. Të tillë mund të për-me--ndim:

a. Zhvillimet teknologjike. Kjo fushë është e lidhur ngu-shtë me zhvillimet e teknologjisë, për përsosjen e mje-teve që përdoren në shërbimet mjekësore. Pra-n-daj, vi-teve të fundit, në këtë fushë dëgjohej të flitet për: eko-grafi, rëntgenografi, skaner, klonim.

b. Kontaktet ndërghjuhësore. Kontaktet me vendet e hu--a-ja u bënë shkak për depërtimin e një vargu fjalësh në leksikon e shqipes, që përdoren sot në fushën e mje--kësisë. Këto emërtime kanë të bëjnë më së shumti me disa emra degësh të mjekësisë dhe të specia-li-s-të-ve të këtyre degëve: epidemiologji, alergolog, aler-go--lo-gji,

dietolog, reumatolog, toksikologji, anes-te-zist, fizio-terapist. Ndoshta kemi kaq shumë fjalë të hu-a-zuara në këtë fushë, pasi dhe literatura e përdorur si burim për botimet shkencore, në pjesën më të ma-dhe të rasteve, vjen nga jashtë. c. Emërtime popullore. Nga ky faktor vihet re se emë-rtimet popullore hasen më së shumti tek emrat e së--mundjeve të njerëzve dhe të kafshëve dhe më pak për mjetet e përdorura a specialistin e fushës. Nëse kra--hasojmë emrat e huazuara të sëmundjeve me ato të kri-juara nga vetë populli mund të themi se, emër-ti-met po--pullore të sëmundjeve (të njerëzve dhe të kaf-shëve) pi--kënisjen e marrin kryesisht nga pjesa e tru-pit që dë--mtohet nga sëmundja: gushël, nëntho-njéz, gji--njéz, shpretkéz, grykëkeqe (difteri), grykëba-r-dhë (di-f-teri), mi-shëz (plasja).

Më pak emërtime sëmundjesh e marrin emërtimin nga she-nja e sëmundjes: qorrth (sëmundje që të vesh sytë me perde), të shkumtë (epilepsia), çalë, eth-na-jë (ethe e rëndë).

Ndërsa emërtimet e huazuara, pikënisjen e marrin kry-e-sisht nga shenjat e sëmundjes: inflamacion (pe-z-ma-tim...që shfaqet me skuqje), anoreksi (mun-gesë ore--ksi), stres (brenjë që vjen nga trysnia trupore a me--ndore), shokoj (shkaktoj gjendje shoku).

Mbështetur në këto raste mund të themi se, në emër-ti-met e reja popullore të sëmundjeve, këto vitet e fu-n-dit, ne jemi mbështetur më së shumti tek pjesa e së-mu-rë e trupit, sesa tek shenja më kryesore me të cilën një sëmundje shfaqet.

Veç fjalëve të reja, të cilat e zgjerojnë leksikon e kë-saj fushe, kemi edhe fjalë të cilat kanë kaluar në le-k-si-kun e vjetruar apo po bëhen pjesë e tij. Pra, kemi fja-lë që nuk ndodhen në fjalorin e vitit 2006. Të tilla lek-se-ma emërtojnë:

a. sëmundje: harmi (tuberkuloz), gërdec (sifiliz), bërdalec (sifiliz) etj.

b. mjete të mjekësisë: neshter (thikë e hollë), mirrë (rrëshirë), bandazh (fashë) etj.

c. specialistin në bazë të pjesës së trupit që shëron: dhëmbëtari etj.

Për të pasqyruar më mirë se sa është zgjeruar kjo fu-shë na vjen në ndihmë tabela e mëposhtme:

Tabela për fushën e mjekësisë

Fjalorët nr. i leksemave

Fjalorthi 1980 ≈ 31

Fjalorthi 2006 ≈ 147

Në këtë fushë gjejmë mjaft fjalë monosemantike dhe me më shumë se një kuptim, madje mund të gjejmë edhe fjalë me kuptime të figurshme. Pasqyra e më-po-sh--tme na vjen në ndihmë për të krijuar një ide më ko-n--krete të strukturës kuptimore të fjalëve të kësaj fu-she për njësitë e fjalorthit të 2006-ës në krahasim me fja-lo-rthin e 1980-ës:

Fjalorthi 1980: nr. i leksemave përqindja

Fjalë me një kuptim ≈ 21 68%

Fjalë me më shumë se një kuptim ≈ 8 26%

Fjalë me kuptim të figurshëm ≈ 2 6%

Fjalorthi 2006: nr. i leksemave përqindja

Fjalë me një kuptim ≈ 123 79%

Fjalë me më shumë se një kuptim ≈ 24 15%

Fjalë me kuptime të figurshme ≈ 9 6%

Këtu del qartë se nga ≈ 147 fjalë a terma që kanë hyrë kë-to dhjetëvjeçarët e fundit në fushën e mjekësisë (dhe janë bërë pjesë e fjalorit të vitit 2006), rreth 79% e tyre janë fjalë a terma (kryesisht terma) me vetëm një kuptim, rreth 15% e tyre kanë më shumë se një ku-ptim dhe vetëm 6% e tyre kanë edhe kuptime të figurshme.

Duhet sqaruar që nga rreth 24 fjalë që kanë më shumë se një kuptim, rreth 9 prej tyre kanë vetëm dy ku-p-ti-me, ku kuptimi i dytë është dhe kuptimi i figurshëm; rreth 3 prej tyre kanë tre kuptime (ku ndërkohe vetëm tek 2 kuptime kemi si kuptim të tretë kuptimin e fi-gu-r-shëm); dhe 13 njësi të tjera kanë dy kuptime pa qenë as-njëra prej tyre e figurshme. Për shembull:

alergjí, -ke mb. 1. mjek. që lidhet me alergjinë, i ale-r-gji-së; që vuan nga alergjia: sëmundje alergjike; 2. fig. Shu-më i ndjeshëm ndaj dikujt a ndaj diçkaje që nuk e duam: tip alergjik;

asfiks/ój kal., -óva, -úar 1. mjek. i ndaloj frymëma-rr-jen, i zë frymën: qymyri të asfikson. 2. fig. libr. e vë në gjendje asfiksie;

delír, -i m. 1. mjek. kllapi, jerm, përcartje. 2. fig. përcartje; dalldi, shastisje;

harmi, -a f. veter., mjek. 1. Tuberkuloz i kockave (kryesisht për kafshët). 2. sëmundje që bren e prish dhëmbët. 3. fig. frikë e madhe; lemeri; hardhíz/ë, -a f. sh. -a (t) 1. mjek. sëmundje e ti-ro-i-de-ve ose e strumës. 2. bajamet dhe sëmundja e tyre.

Përfundime

Nga vëzhgimet e bëra rezulton se fushat e marra në shqy-rtim e kanë zgjeruar përbërjen e tyre leksikore më së shumti me fjalë të burimit të huaj, pasi edhe no-ci-onet e reja apo botëkuptimet e reja të fituara me ve-n-dosjen e pluralizmit janë rezultat i ndikimit që ve-n-det perëndimore kanë ushtruar mbi vendin tonë. Ndi-ki-mi më i madh është ndier në fushën e politikës dhe të drejtësisë. Kjo fushë ka lënë "prapa" shumë fjalë dhe është pasuruar me shumë të tjera si: euro-par--la-me-n-tar, europerëndimor, komisioner, kongres-men, mo-cion, pluralist, ndërkuftar, të cilat nuk shprehin më një qëndresë kundër Evropës, por një dëshirë për t'u bërë pjesë e saj.

Në fushën e mjekësisë huazimet kanë qenë të pa-sh-ma-ngshme si pasojë e zhvillimit të teknologjisë dhe kon-takteve me vendet e huaja. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se kjo fushë, gjatë këtyre viteve, është pasu-ruar vetëm me fjalë të huaja. Në të gjejmë edhe një sërë fjalësh të tjera shqipe, të cilat shënojnë sërë-mu-n-d-jen duke iu referuar pjesës së trupit të dëmtuar nga sërë-mu-ndja apo shenjave të sëmundjes.

Bibliografia

AKADEMIA e Shkencave të Shqipërisë (1980), Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë.

AKADEMIA e Shkencave të Shqipërisë (2006), Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë.

LLOSHI, Xhevat (2002), Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike: Gjuha jonë, nr 3-4, Tiranë.

RROKAJ, Shezai (2009), Shqipja në epokën e globa-li-zimit dhe identiteti i saj: Çështje të gjuhës shqipe 2, Tiranë.

SAMARA, Miço (2007), Rreth zhvillimit të leksikut politik – shoqëror në gjuhën shqipe: Studime filologjike, nr. 1-2, Tiranë..